**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAVAJË**

Kavajë, më ____.____.2026

**PROJEKT - VENDIM**

**Nr._____date._____._____. 2026**

**NJE NDRYSHIM MBI VENDIMIN Nr.59 DATE 16.12.2025 ''MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 DHE BUXHETIN 2026'' PER RISHPERNDARJEN MIDIS PROGRAMEVE BUXHETORE**

Keshilli Bashkiak Kavaje ne mbledhjen e tij te dates_ . .2026, me propozim te Kryetarit te Bashkise, mbeshtetur ne nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 34, 40, 41, 54 shkronja "dh" te ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 te ligjit nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise" te ndryshuar, ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin"te ndryshuar; Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 23 date 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV", Udhëzim nr. 6, datë 27.2.2026, Për përgatitjen e PBA 2027-2029 me shtojcat plotesuese; Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 9 date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar; Udhezimin Nr. 2, date 14.01.2026 "Per zbatimin e buxhetit te vitit 2026" *Per te Ardhurat e Trasheguara dhe te Pa Perdoruara nga viti 2025''*,referuar Akt-rakordimit me Degen e Thesarit dhe Relacionit te administrates se Bashkise Kavaje me miratim te Kryetarit te Bashkise,

**I PROPOZON:**

1. Keshillit Bashkiak te miratoje Rishperndarjen midis programeve ne Buxhetin e vitit **2026**,nga Te Ardhurat e veta Kapitulli 05 :

2. Pjese e ketij vendimi eshte dhe dokumentacioni shoqerues i cili perfshin informacion te detajuar per te ardhurat vendore dhe per shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimeve buxhetore si dhe objektivat kryesore te programeve te njesise se veteqeverisjes vendor.

3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas percaktimeve te pikes 6 te nenit 55 te ligjit 139/2015 *"Per veteqeverisjen vendore"* dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni Prefektit te Qarkut Tirane.

**DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE**

**ALBI LUSHKA**

**DREJTORIA JURIDIKE**

**HELIDON PLAKU**

**SEKRETAR I KESHILLIT BASHKIAK**

**MERI BITURKU**

**DREJTORIA E KULTURES DHE SPORTIT**

**GENTIAN JAUPI**

**KRYETARI**

**FISNIK QOSJA**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAVAJË**

Nr._____ Prot.

Kavajë, më . . 2026

**Lënda: Rishperndarje e fondeve midis programeve Buxhetore propozuar Keshillit Bashkiak:**

Ne mbeshtetje te ligjit nr.139/2015 "*Per veteqeverisjen vendore*", ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "*Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise*, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 "*Per financat e veteqeverisjes vendore*", shkresa e Ministrise se Financave nr. 15867 prot date 06.11.2025 " *Dergohet transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2026* ", ne Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.59, date 24.12.2025 "*Per miratimin e programit buxhetor afatmesem 2026-2028 dhe buxhetin e vitit 2026*", miratuar nga Prefekti i Qarkut Tirane me shkresen nr.1752/1 prot, date 24.12.2025"Verifikim ligjshmerie" ligjit nr.9632 " *Per sistemin e taksave vendore* ", ligjit nr. *10296* " *Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*", ,Aktit Normativ nr.11 date 19.12.2025,Udhezimit te Ministrit nr.9,date 20.03.2018 ''Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit'', *Udhezimit nr.2 date 14.01.2026 ''Per zbatimin e buxhetit te vitit 2026''*

1. Shkresen nr. 2562 prot. Date 25.05.2026 "*kerkese-rialokim/shtim fondi per Drejtorine e Kultures dhe Sporteve*"
2. Tabela e detajimit te fondit.

| | **Llogaria** | **Grupi** | **Kapitulli** | **Kodi programit** | **Pakesohet/shtohet** | **Vlera ne Lek** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **602** *Vendime Gjyqesore* | 00 | 05 | 1110 | Pakesohet | 14,000,000 |
| | **602** *Aktivitetet e Kultures dhe Sporteve* | 00 | 05 | 8220 | Shtohet | 14,000,000 |
| | | | | | | |

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

**K R Y E T A R I**

**FISNIK QOSJA**

*Detajimi: Erdi Berati*

Adresa: Bulevardi "Josif Budo", Lagje Nr. 1, Kavajë, Shqipëri,

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr.361 Prot.

Datë, 25/05/2026

# KËRKESË

**Drejtuar : Drejtoria e Burimeve Ekonomike**

**Lënda: Kërkesë për rialokim/shtim fondi për Drejtorinë e Kulturës dhe Sporteve.**

Përmes kësaj shkrese kërkojmë nga ana e Drejtorisë së Burimeve ekonomike, marrjen parasysh të kërkesës së Drejtorisë së Kulturës dhe Sporteve për shtesë në buxhetin e Drejtorisë së Kulturës dhe Sportit nga fondet 602 që do ti paraqitet Këshillit Bashkiak në mbledhjen e rradhës. Duke qenë që buxheti dedikuar kulturës nuk përmbush nevojat dhe objektivat e kësaj drejtorië kërkojmë nga ana juaj:

**- Shtesë fondi prej 14.000.000 (katërmbëdhjetë milion lekë)**

Bashkëlidhur do të gjeni listën e aktiviteteteve me zërat përkatëse.

**DREJTORI**
**GENTIAN JAUPI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr.____Prot.

Datë,____/____/2026

**Prioritetet kryesore në fushën e Kulturës janë:**

- ***Teatër Kukullash (fondi limit 700.000 lekë)***

Teatri i Kukullave sjell buzëqeshje, fantazi dhe emocione për të vegjlit. Përmes personazheve dhe historive të ndryshme fëmijët udhëtojnë në një botë që i ndihmon të zhvillojnë imagjinatën, kreativitetin dhe dashurinë për artin, duke i afruar me teatrin në një moshë të vogël.

- ***Hapja e Sezonit Turistik (fondi limit 3.000.000 lekë)***

Bashkia Kavajë çel zyrtarisht sezonin turistik duke mirëpritur vizitorë vendas dhe të huaj në një nga destinacionet më të bukura bregdetare. Një festë e mbushur me aktivitete për të gjitha moshat. Aktivitetet festive, eventet kulturore do të shoqërojnë këtë sezon duke e kthyer qytetin në një pikë të rëndësishme atraksioni gjatë verës.

- ***1 Qershor "Dita e Fëmijëve" Festival ii këngës (fondi limit 1.000.000 lekë)***

Një festë plot ngjyra, gëzim dhe buzëqeshje për fëmijët. Lojëra argëtuese, shfaqje artistike, kënde kreative dhe shumë surpriza të përgatitura vetëm për fëmijët.

- ***Verë dhe Portokalle (fondi limit 1.000.000)***

Në një atmosferë verore dhe festive, plot humor dhe argëtim për të gjithë, publiku do të shijojë performanca plot batuta, personazhe të dashur që garantojnë të qeshura pa fund.

- ***Open Cinema(fondi limit 600.000)***

Bashkia Kavajë sjell "Kinemanë e Hapur" një eksperiencë unike që bashkon artin e filmit me natyrën. Të rinj dhe familje do të kenë mundësinë të shijojnë filma të përzgjedhur në ambiente të hapura, duke kaluar një mbrëmje të këndshmë plot argëtim.

- ***Ditët e Kavajës (fondi limit 3.000.000)***

"Ditët e Kavajës" aktivitete të mbushura me muzikë, argëtim që bashkojnë komunitetin dhe vizitorët në një atmosferë festive përgjatë të gjithë muajit gusht. Një mundësi për të shijuar kultuën, muzikën dhe energjinë e Kavajës.

- ***Maratona e Këngës Popullore (fondi limit 1.000.000)***

Një aktivitet që nderon dhe promovon traditën muzikore shqiptare. Një mundësi e veçantë për publikun të shijojë artin e këngës tradicionale nga këngëtarë të mirënjohur dhe të bashkohet në festimin e muzikës që ka mbetur pjesë e identitetit tonë kulturor.

Prioritetet kryesore në fushën e Sportit janë:

- ***Kampionat Mini futbolli (kalçeto) (fondi limit 1.000.000)***

Një aktivitet sportive që mbledh ekipe të rinjsh dhe dashamirës të futbollit për garë dhe argëtim. Kjo është një mundësi për të nxitur aktivitetin sportive, shëndetin dhe frymën konkurruese tek të rinjtë e komunitetit tonë.

- ***70- Vjetori i Gjimnazit "Aleksandër Moisiu" (fondi limit 2.000.000lekë)***

Një histori suksesi, përkushtimi dhe dijesh që vijon prej 70 vitesh. Një përvjetor që sjell në vëmendje brezat e nxënësve dhe mësuesve që kanë kontribuar në formimin e vlerave dhe arsimit në komunitetin tonë. Në kuadër të këtij jubilee do të zhvillohen aktivitete përkujtimore, artistike dhe kulturore, që pasqyrojnë rrugëtimin dhe arritjet ndër vite.

- ***80- Vjetori i Themelimit të Shkollës "Mehmet Babamusta" (fondi limit ----)***

Një rrugëtim 80-vjeçar i mbushur me dije, përkushtim dhe vlera edukative. Shkolla "Mehmet Babamusta" feston këtë jubile të rëndësishëm, duke nderuar brezat e nxënësve dhe mësuesve që kanë kontribuar në formimin e saj ndër vite. Në kuadër të këtij përvjetori do të zhvillohen aktivitete artistike dhe kulturore që sjellin në vëmendje historinë dhe arritjet e shkollës.

- ***Java e Librit (fondi limit 1.300.000 lekë)***

Bashkia Kavajë i kushton një vëmendje të veçantë librit dhe leximit duke organizuar aktivitete që nxisin dashurinë për dijen dhe kulturën. Takime me autorë, promovime librash, aktivitete dhe diskutime letrare duke e kthyer librin në qendër të jetës kulturore të qytetit.

- ***Miss & Mister Kavaja 2026 (fondi limit 1.000.000)***

Një event i shumëpritur që promovon talentin dhe personalitetin e të rinjve të qytetit. Pjesëmarrësit do të konkurojnë përmes paraqitjeve të ndryshme, ndërsa një juri profesionale do të vlerësojë performancat e tyre.

- ***Koncert per festat e Nentorit (fondi limit 500.000 lekë)***

Në kuadër të festimeve të Ditës së Pavarësisë, Bashkia Kavajë organizon koncert festiv me qëllim krijimin e një atmosfere festive për qytetarët për të nderuar historinë dhe sakrificat për liri, si dhe për të forcuar ndjenjën e identitetit dhe unitetit kombëtar në komunitet. Një koncert me interpretime të këngëve patriotike dhe muzikës tradicionale shqiptare, shoqëruar me valle popullore dhe elemente artistike që promovojnë trashëgiminë kulturore të vendit.

- ***Pazari i Festave (fondi limit 4.000.000)***

Gjatë muajit dhjetor "Pazari i Festave" një aktivitet i përditshëm festiv që zhvillohet në sheshin kryesor të qytetit. Qendra e qytetit shoqërohet çdo ditë me programe artistike, ku do të performojnë këngëtarë të mirënjohur të skenës shqiptare, DJ dhe grupe të ndryshme muzikore, duke krijuar një atmosferë argëtuese për të gjitha grupmoshat gjatë gjithë muajit Dhjetor.

- ***Sofra e Kavajës (fondi limit 5.000.000 lekë)***

Ky event festiv i organizuar në formën e një festë tradicionale me performancë nga këngëtarë të mirënjohur të muzikës shqiptare duke krijuar një atmosferë festive dhe argëtuese për të gjithë pjesëmarrësit. Ky event bashkë personalitete të afirmuar të fushave të ndryshme që kanë kontribuar vazhdimisht në lartësimin dhe nderimin e emrit të qytetit.

- ***101-Vjetori i Themelimit të Klubit Sportiv Besa Kavajë (fondi limit 200.000)***

Një histori krenarie që vijon prej 101 vitesh. Ky jubile është një homazh për të gjithë sportistët, trajnerët dhe tifozët që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi duke e kthyer "Besën" në një simbol të sportit dhe identitetit të qytetit të Kavajës. Në kuadër të këtij përvjetori do të zhvillohen aktivitete sportive dhe festive, që bashkojnë komunitetin në një atmosferë krenarie dhe emocioni.

**DREJTORI**

**GENTIAN JAUPI**